



INFRASTRUKTURA/ PARKIMI

## PARKIMI I BIÇIKLETËS NË ZONAT REZIDENCIALE

### Vështrim

Në zonat rezidenciale, rezidentët duhet të kenë vend të sigurtë magazinimi biçikletash gjatë natës. Ky është një kusht për të nxitur pronësinë e biçikletave dhe pedalimin e tyre. Në vendbanimet e reja përmes marrëveshjes dhe rregullimit duhet të ketë vend standart, të mjaftueshëm për magazinimin e biçikletave. Ndërsa në zonat e vjetra pa mjedise të brendshme private, duhen gjetur mundësitë për t'i krijuar këto lloj shërbimesh për ruajtjen, sigurimin, bashkë-menaxhimin dhe madje përdorimin e përbashkët nga të gjithë rezidentët. 'Daullet e biçikletave' janë vend-qëndrime në-rrugë, praktike, të vogla dhe kolektive.

### Sfondi dhe Objektivat

#### Funksioni

Mënyra e parkimit të biçikletave kryesisht në lidhje me ruajtjen e tyre të sigurtë gjatë natës në zonat rezidenciale është e nevojshme t'u ofrohet banorëve, sidomos kur mungon hapësira private e ruajtjes. Kjo nxit pronësinë për biçikleta dhe përdorimin e tyre.

#### Qëllimi

Të gjithë vend strehimit kanë nevoja për shërbime të përshtatshme për ruajtjen e biçikletave. Kjo është një nga tre komponentët e domosdoshëm të zinxhirit të udhëtimit: ruajtja në shtëpi, pedalimi në një rrjet pedalimi dhe parkimi ose magazinimi në destinacion.

Politika e parkimit të biçikletës zakonisht fokusohet fuqishëm tek destinacioni. Po kaq rëndësi ka edhe shërbimi i parkimit në shtëpi.

Zakonisht, problemi lind në zonat e banuara, të dendura me apartamente apo shtëpi të vogla që kanë mungesë garazhesh ose hapësirash të tjera për magazinim. Kjo është tipike për qendrat historike dhe ndërtesat e shekullit të nëntëmbëdhjetë. Por mund të paraqitet si problem edhe në lagjet me banesa të vogla, të zhvilluara kohët e fundit.

Hapësira për të mbajtur një biçikletë brenda në shtëpi, për çdo anëtar të familjes përgjithësisht mungon. Vetëm pedalesit e përkushtuar do të marrin mundimin të ngrejne biçikletën shkallëve apo ta parkojnë në një korridor të ngushtë, në shkalla, në një bodrum apo edhe në dhomën e banesës së tyre.

Parkimi i biçikletës në rrugë gjatë natës është i papërshtatshëm dhe i rrezikshëm. Në Hollandë, gjysma e të gjitha biçikletave të vjedhura janë zhdukur pranë shtëpive të pronarëve. Të qenurit gjithmonë të detyruar ta lidhin diku biçikletën përbën telash. Nëse biçikleta është gjithmonë jashtë dhe e zbuluar, do të degradojë më lehtë, apo do të jetë e kërcënuar. Shumë biçikleta të parkuara në trotuare shpesh bëhen pengesë dhe problem vizual.

Një situatë e tillë në shtëpi dekurajon pronësinë e biçikletës dhe përdorimit të saj, edhe kur ekziston një rrjet i shkëlqyer pedalimi dhe parkimi adekuat në vendmbërritje.

Në shtëpitë të reja, magazinimi i mjaftueshëm për të gjithë biçikletat duhet të bëhet një masë standarte.



## Zbatimi

### Përkufizimi

---

Vendparkimi i biçikletës në zonat e banuara është hapësirë e siguar për ruajtjen edhe gjatë natës së biçikletave të banorëve. Për shtëpitë e reja, masat e parkimit në shtëpi duhet të integrohen dhe të bëhen të detyrueshme që prej fillimit të zhvillimit të projektit, sipas rregulloreve të ndërtimit. Në lagjet ekzistuese, në shtëpitë pa hapësira private të magazinimit mund të gjendet një zgjidhje për ruajtje kolektive. Kjo mund të marrë formën e një shërbimi për lagjen, në një zonë të mbyllur apo ndërtesë. Një alternativë janë dollapët e vegjël dhe kolektivë, në rrugë.

### Vlerësimi i nevojave dhe kërkesës në zonat ekzistuese rezidenciale

---

Problemet kryesore në shtëpitë dhe banesat e vogla janë mungesa e hapësirës brenda në shtëpi dhe rreziku i vjedhjes në rrugë gjatë natës. Ky problem nuk mund të zgjidhet në nivel të çdo banese individuale por mund të jetë efektiv vetëm një zonë e gjerë qasjeje.

Zonat e përzgjedhura për një përjasje të tillë janë:

Zona rezidenciale kryesisht me apartamente dhe shtëpi pa hapësirë të tyre të magazinimit;

Zona rezidenciale, të çrregullta me biçikleta të parkuara gjatë natës;

Zona rezidenciale me normë vjedhjesh të biçikletave më të lartë se mesatarja.

Për të vlerësuar nevojën duhet të mblidhen të dhënat e mëposhtme:

Norma e pronësisë së biçikletave.

Niveli i hapësirave të magazinimit të biçikletave për banesë.

Normat relative të vjedhjeve të biçikletave. Statistikat e vjedhjeve janë tejet të nënvlerësuara, pasi ato nuk janë të shpallura. Megjithatë, krahasuar me normat mesatare të vjedhjeve në zona të hapura ose rrugë është një tregues i vlefshëm.

Numri i biçikletave të parkuara brenda natës, si në rrugë ashtu edhe ambiente të mbyllura.

Dëshirat e banuesve, përmes një sondazhi. Pronarët e biçikletave mund të pyeten nëse ata do të donin të parkonin në vende të tjera të ndryshme nga ato ku parkojnë tani. Atyre, të cilët nuk zotërojnë një biçikletë mund t'u kërkohet nëse një vend i mirë parkimi do t'i nxishte ata për të blerë një të tillë.

Me këto të dhëna mund të vlerësohet nevoja, sasia dhe vendi shtesë për parkimin e biçikletave në lagje. Krijimi i vendit shtesë për ruajtje mund të rekomandohet në ndonjë nga situatat e mëposhtme apo një kombinim i tyre.

Në rrugët me nivel të lartë të vjedhjes së biçikletës, dhe jo në ambiente të mbyllura të mjaftueshme të magazinimit.

Shtim parkimesh në rrugët për parkimin e biçikletave, dhe jo në ambiente të mbyllura të mjaftueshme të magazinimit (madje me ritme të ulëta vjedhje).

Në rastet kur ka pak biçikleta për familje dhe pak vende magazinimi, sigurohet ka edhe më shumë vjedhje dhe banorët do të shprehin një kërkesë.

Një kërkesë nga rezidentët për hapësira shtesë të parkimit, ndoshta shton pronësinë e biçikletave.

### Objektet e magazinimit në lagje

---

Autoritetet publike mund të krijojnë dhe drejtojnë specifike për hapësirat e magazinimit në lagje: ndërtesa, pjesë të ndërtesave apo zona të mbyllura të përdorura për parkim biçikletash.

Qasje e kufizuar për një grup të caktuar të banorëve lokalë. Çdo banor ka një hapësirë parkimi të rezervuar dhe qasje në të gjitha kohët me një çelës ose smart card.

Mundësitë e hapjes së hapësirës në dispozicion. Ndërtimet e reja mund të integrohen në sheshe publike ose në plote të lira ndërmjet banesave. Në këtë rast, autoritetet janë të

varura nga mundësia e përdorimit të tokës në funksion të parkimit dhe ruajtjes, e cila mund të rezultojë e kushtueshme. Megjithatë, shpesh ka mundësi për përshtatje të hapësirës të tillë si hapësirë e papërdorur komerciale ose kati përdhe, apo bodrumi i një ndërtese të madhe private ose publike. Mundësitë e tjera mund të jenë mbulimi i një kopshti të mbyllur, rezervimi i një pjese garazhi nëntokësor makinash, ose thjesht për të kthyer një kuti- garazh për ruajtje biçikletash, të përbashkët.

Konsideroni shtimin e një hapësire të vogël, të përbashkët për mjete riparimi.

Kufizimi i distancës për ecje për përdoruesit në max. 150 m. Vend i mirë është ai që mund të arrihet nga përdoruesit brenda kësaj distance. Kjo është bazuar në përvojën hollandeze (shih tabelën më poshtë), dhe mund të ndryshojë gjatë.

Distanca maksimale e ecjes drejt parkimit në lagje	E pranueshme për
75 m	46%
150 m	32%
Më shumë se 150 m	21%

Rritja financiare dhe menaxheriale e duhur. Tarifat vjetore në Hollandë ndryshojnë nga 35 € në 90 €, në kuadër të politikës së mirëmbajtjes së tyre nën 50 €. Vullneti për të paguar është i ndryshëm dhe mund të anketohet paraprakisht tek përdoruesit potencial. Në përgjithësi, shërbimi i ruajtjes në lagje nuk do të jetë i zbatueshëm nga ana e biznesit privat pa mbështetjen e publikut. Megjithatë, pronarët e një hapësirë të pashfrytëzuar mund të kenë përfitime të vogla. Kështu hapësira për motoçikleta dhe motorra mund të rrisë rentabilitetin: hapësira për ta është e reduktuar ndaj pronarët shpesh janë të gatshëm të paguajnë tarifa më të larta. Detyrat kryesore të menaxhimit janë regjistrimi i përdoruesve, mbledhja e taksave dhe mirëmbajtja (jo mbikëqyrje e përhershme). Personi që menaxhon duhet mundësisht të jetë afër, që ta ketë të lehtë për të arritur në rast emergjence. Hartimi i një kontrate me çdo përdorues është e rekomandueshme.

Konsiderojeni si një përfaqje të udhëhequr nga kërkesa. Në vend që të merren iniciativa të zhvendosjes së magazinimit në lagje, autoritetet mund të përgatisin të gjitha procedurat dhe të ftojnë banorët që të propozojnë nisma. Kjo ka avantazhin e dyfishtë: ka disa ide të kërkesës reale, dhe banorët mund të zbulojnë në mënyrë aktive dhe të propozojnë mundësitë e lokalizimit të këtij shërbimi.



Magazinimi kolektiv në lagje, jashtë dhe brenda (burimi i imazhit: F. Boschetti, T. Asperges)

### 'Daullet e biçikletave' në rrugë

Nëse kërkesa është relativisht e shpërndarë apo mund të gjenden mundësitë për një depo kolektive, një tjetër mundësi është sigurimi i dollapëve të vegjël kolektivë. 'Daullet e biçikletave' janë një prej llojeve të dollapëve kolektivë të konceptuar posaçërisht për ruajtje në lagje.

Ata mund të ruajnë 5 deri 8 biçikleta dhe janë të dizenuar për t'u përshtatur me një hapësirë parkimi. Janë më të vegjël se një depo e lagjes, por mund të shumëfishohen duke reduktuar distancën mesatare për shtëpitë. Qytetet hollandeze kanë me qindra 'daulle biçikletash', të shpërndara në të gjitha zonat rezidenciale të qytetit.

Procedura për leje ndërtimi duhet të jetë efektive për të minimizuar kohën e nevojshme.

Një disavantazh është se ato mund të jenë mjaft të shtrenjta për një numër të kufizuar të përdoruesve. Autoritetet duhe të kontrollojnë çmimet.

Mund të ketë fillimisht kundërshtime estetike të këtyre objekteve. Megjithatë, në qoftë se zëvendësojnë një makinë të parkuar, ndikimi vizual është mjaft i pranueshëm, dhe modelet janë të pranueshme për shikimin<sup>1</sup> dhe transparente.<sup>2</sup>



Një daulle biçikletash në korsinë e parkimit të një rruge lagjeje, me një shtyllë mbrojtëse. Utrecht, Holl<sup>3</sup>



Daulle biçikletash transparente, dizajn 'i dukshëm'.<sup>4</sup>

### Parkimi i biçikletës në strehimet e reja

Në përgjithësi, parkimi i biçikletave duhet të integrohet në të gjitha proceset e planifikimit. Nëse pedalimi konsiderohet si një mënyrë transporti, atëherë qasja e biçikletës duhet të planifikohet në të gjitha ndërtesat e reja si dhe në skemat e rinovimit urban. Nuk ka asnjë arsye pse ky standart për parkimet e biçikletës të mos zbatohet.

Banesat e reja duhet të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme magazinimi të një biçiklete për çdo zotërues.

Të sigurohet kërkesa për ruajtjen e biçikletave në rregulloret e ndërtimit për strehimet e reja. Kjo duhet të përfshijë minimalisht, ofertën për hapësirë të mjaftueshme të magazinimit të biçikletave për të gjithë banorët. Ata mund të përcaktojnë nevojën minimale të hapësirës së kërkuar, për shembull numrin e hapësirave të parkimit të biçikletave ose zonën në lidhje me numrin e banesave apo zonës rezidenciale (për shembull; 1 për banesë + 1 për çdo dhomë gjumi).

Të sigurohet magazinimi i biçikletave për secilën banesë, individualisht ose kolektivisht. Magazinimi kolektiv është më i përshtatshëm në ndërtesat e banimit shumëkatëshe, për shembull në katin përdhes ose një hapësirë e mbrojtur dhe e mbuluar në frontin e ndërtesës.

Garancia e sigurisë sociale. Të gjitha vendet e brendshme të magazinimit duhet të jenë lehtësisht të arritshme nga niveli i rrugës, dhe shumë të dukshme. Ato duhet të jenë pranë hyrjes së ndërtesës, për të rritur sigurinë dhe në afërsi të shkallëve apo ashensorit, për të krijuar një rrugë sa më të shkurtër. Magazinimi kolektiv duhet të ndahet në njësi të vogla (rreth 12 biçikleta), kështu që përdoruesit do të dinë vendet e tyre përkatëse. Shmangni korridorët e vogla dhe të fshehta përreth apo edhe në pjesën e pasme të ndërtesave.

Sigurimi i parkimit në-rrugë për vizitorë të integrohet që prej fillimit të projektimit të banesës.

Gjithnjë e më shumë, qytetet janë duke eksploruar potencialin e lagjeve të reja të qëndrueshme. Shpesh këto lagje janë konceptuar si vend- banime me përdorim të ulët të makinave. Parimi është se këto banesa janë pjesërisht të rezervuara për banorët që nuk zotërojnë një makinë. Në

<sup>11</sup> Shikoni fletwn e informimit mbi SISTEMET E PARKIMIT DHE ZGJIDHJET E RUAJTJES

<sup>22</sup> Shikoni fletwn e informimit mbi SISTEMET E PARKIMIT DHE ZGJIDHJET E RUAJTJES

<sup>3</sup> Burimi i imazhit: <http://static.panoramio.com/photos/original/15084198.jpg>

<sup>4</sup> <http://groenerik.files.wordpress.com/2009/03/fietstrommel.jpg>



## Jepi një Shtysë Pedalimit

Fletë Informimi për Zbatim

këmbim, ata kanë qasje në një gamë të gjerë të zgjidhjeve të lëvizshmërisë alternative, duke përfshirë transportin publik, makinat e përbashkëta dhe sigurisht edhe biçikletën.



Magazini i biçikletave i sigurtë dhe i shikueshëm nga jashtë  
Porsmouth, MB  
Burimi i imazhit: Cycling England, Tony Russell



Zhvillime rreth biçikletës në Vjenë.  
Burimi i imazhit: Fietsberaad

## Konsiderata

### Pikat e forta

Parkimi i biçikletës nëpër lagje

Siguron ruajtjen e biçikletave gjatë gjithë-natës për banorët

Nxit zotërimin dhe përdorimin e biçikletave

Mund të përfshijë banorët në përdorimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të përbashkëta

### Pikat e dobëta

Parkimi i biçikletave nëpër lagje

Kërkon kohë dhe përpjekje për të krijuar rrjetin e shërbimeve për: blerjen e ndërtesave, mirëmbajtjen, lejen e ndërtimit

Mund të mos ketë mbështetje për shkak të reduktimit të hapësirës së parkimit të makinave ose për arsye estetike (në rastin e 'daulleve të biçikletave').

### Mundësitë alternative

Alternativa e vetme është pranimi i parkimit kaotik dhe të pasigurt të biçikletave mbi-rrugë dhe nivelet e ulëta të pronësisë së biçikletave. Biçikletat publike mund të shërbejnë për përdorim të rastit, por janë më pak të përshtatshëm dhe më të kushtueshme se mbajtja e biçikletës personale.